



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**

## **E K S T R A K T**

i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Komunitete, mbajtur më 28.2.2024, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Nenad Miladinoviq, Elmira Nikçi - Rexha, Oktay Kurtesh, Kimeta Shok dhe Adnan Ajeti.

**Munguan:** Trieria Kasumi - Berisha dhe Faton Marolli.

Në mbledhje morën pjesë edhe: përfaqësuesit e KFOR-it, Arianita Beqa - Raci UNMIK, Klaudia Mula, zyrtare për komunitete nga ZKKK, Betim Abdullahu, ZKKK, Sala Mustafa, zyrtare nga drejtoria e Mirëqenies Sociale.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Komitetit, znj. Mirsada Behluli, me këtë

### **R e n d t ë D i t ë s :**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;
2. Ftesë për KFOR-in, UNHCR-në, PK-në , ZKKK-në, analiza rreth sigurisë dhe lëvizjes së lirë;
3. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, analiza rreth projekteve të komuniteteve jo shumicë ;
4. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale;
5. Takim me zyrtarët e Departamentit për komunitete pranë MKK-së,
  - a) subvencionim MKK-së,
  - b) propozim për ndihma të tjera për komunitetet jo shumicë;
6. Ndihmë për subvencionim përmes Komunës së Prishtinës, biznes privat dhe donacion nga të huajt (OJQ);
7. Raporti i ZKKK-së për muajin janar 2024 ;
8. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre;

Faqe 1 nga 9

## **9. Të ndryshme.**

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

### **Pika e parë**

**Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KK-së.**

Njëzëri u miratua ekstrakti i mbledhjes së kaluar.

### **Pika e dytë**

**Ftesë për KFOR-in, UNHCR-në, PK-në, ZKKK-në, a) analiza rreth sigurisë dhe lëvizjes së lirë**

**Komandanti i KFOR-it** tha se unë tash sa kam ardhur këtu dhe do te jem gjashtë muajt këtu, Unë e vlerësoj shumë të dobishëm këtë takim dhe mezi pres të kemi një bashkëpunim të mirë dhe të ngushtë me ju gjatë këtyre gjashtë muajve.

**Nenad Miladinoviqi** shprehu pakënaqësi lidhur me mospërgjigjen e Policisë së Kosovës, apo mosprezencën e tyre në takim, se nëse veç i është bërë një ftesë Policisë së Kosovës, atëherë pse ata nuk janë prezent sot këtu.

Ndërsa sa i përket prezencës së KFOR-it italian, unë për të satën herë do të shpreh falënderimin tim për bashkëpunimin e mirë, kur është në pyetje komuniteti serb për ndihmën e tërësishme të cilën e kemi pasur nga përfaqësuesit e KFOR-t, kur është në pyetje arsimi, ndihma për rastet sociale, shëndetësia etj.

Pra, edhe njëherë falënderoj KFOR-n italian për bashkëpunimin e mirë dhe kisha pasur dëshirë që kjo të vazhdojë edhe më tutje.

**Mirsada Behluli** u shpreh e pajtimit me vërejtjet dhe falënderoj z. Nenad për vlersimin ndaj KFOR-it, se me të vërtet KFOR-i është gjithnjë prezent në takim, ndërsa UNHCR-ja nuk merr pjesë, PK nuk merr pjesë, Policinë e Kosovës e kemi edhe në Këshillin për Siguri.

Ja pra këtu e kemi Zyrën për Komunitete dhe Kthim.

Sa i përket analizës së sigurisë dhe lëvizjes së lirë, a keni për të thënë diçka lidhur me komunitetet.

**Betim Abdullahu** u shpreh se sa i përket gjendjes së sigurisë, ne si ZKKK nuk kemi marrë ndonjë informatë që ka pasur ndonjë tendencë për prishje të rendit dhe qetësisë tek komunitetet.

Ai në vazhdim tha se zakonisht Prishtina është e qetë sa i përket sigurisë dhe lëvizjes së lirë, është si gjithnjë normale, pa ndonjë problem. Përpos në takimin e kaluar që Nenadi ka paraqitur se janë bërë disa vjedhje, ku dhe besoj se ajo është pjesë e policisë së Kosovës dhe që ata kanë dalë në vend të ngjarjes, pasi që hajnat nuk e dallojnë se cilit komunitet i takon, a është serb, shqiptar apo ndonjë komunitet tjeter.

### **Pika e tretë**

**Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave,**

**a) analiza rreth projekteve të komuniteteve jo shumicë.**

**Mirsada Behluli** lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se kishte qenë mirë që dikush prej drejtorisë të jetë prezent sot këtu, që të na informonte lidhur me analizën e projekteve të komuniteteve jo shumicë, mirëpo ata nuk janë prezent sot këtu. Pra të jemi të informuar se deri ku është arritur puna e projektit në Bërnicë të Poshtme, çka është bërë me projektin për kyqjen në ujësjellës në Slivovë, si dhe kemi informatën për Parkun për komunitetin ashkali, i cili është i përfunduar tërësisht, ndërsa informatat tjera nuk i kemi.

**Betim Abdullahu** lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se është takuar me drejtorin, Krenar Xhaferin, drejtorin e drejtorisë përkatëse, të cilin i është thënë se kontratat të cilat nuk janë të realizuara do të realizohen gjatë këtij viti, pasi që edhe disa prej problemeve janë të asaj natyre, se nuk ka çfarë të bëjë as drejtori, për shkak se procedurat e prokurimit e dimë si janë.

Ai në vazhdim tha se viteve të fundit kanë probleme me firma, për shkak se mungesa e punëtorëve në shumë ndërmarrje nuk kanë aplikuar, i kanë lënë punët në gjysmë për shkak të mungesës së punëtorëve.

Sa u përket projekteve që janë dhënë prej ZKKK-së, ne do t'i shtyjmë përpara, dhe mund të them se drejtoria e cila është duke punuar më së shumti në Komunën e Prishtinës, është Drejtoria e Investimeve Kapitale, ku ka kërkesa të mëdha dhe ka arsyë për të pasur vonesa.

**Nenad Miladinoviqi** tha se jam takuar me nënkyetarin e Komunës, ku më ka ardhur shumë mirë për t'i njoftuar me situatën e përgjithshme dhe mund të ju them se jam shumë i kënaqur me atë takim, ku edhe nënkyetari ka pasur mundësi të shoh se cilat janë problemet. Mirëpo më e rëndësishme është se qëndron kënaqësia me atë që është bërë dhe është realizuar, meqë ato janë investime të vogla, kryesisht janë mjetet që janë përdorur nga buxheti i ZKKK-së.

Ai në vazhdim tha se në propozim të nënkyetarit dhe drejtorit për investime kapitale, qëndron kërkesa për investime Kapitale në Bërnicë të Poshtme, ku ekziston projekt që të realizohet kanalizimi qendror, i cili kishte me i mbledhur të gjitha mbeturinat përreth, e njëherësh edhe rregullimit të shtratit të lumit. Ajo çka na ka informuar drejtori i Investimeve Kapitale, është se ekziston projekt për ato punë, ku vlera e atij projekti është 1 milion euro, dhe kjo do të jetë prioritet nga Komuna e Prishtinës për vitin 2025.

Ai mes tjerash tha se e kam informuar nënkyetarin edhe për deponinë ilegale të mbeturinave në Bërnicë të Poshtme, për të cilat flas qe një vit e diçka.

**Betim Abdullahu** u shpreh se sa i përket deponisë, tha se e di deponinë pasi që kaloj çdo ditë andejpari. Nenadi e dinë se ajo deponi 5-6 herë është pastruar, ku edhe pjesën e parë të autostradës në hyrje e kanë bllokuar me beton dhe nuk kanë mundur të hedhin mbeturina aty, por është një pjesë më brenda ku gjuajnë rregullisht, por aty është problemi asisoj, që të mbylljet aty duhet të mbylljet një pjesë e autostradës.

Nuk e di se çfarë të drejte kanë, sepse ajo është në kompetencë të Ministrisë së Transportit, kur aty do të mbyllej hyrja është shumë keq, se e di shumë mirë atë vend, është shumë keq sepse po i djegin mbeturinat, por problemi është tek vetëdijesimi i qytetarëve.

**Nenad Milladinoviqi** theksoi se sa i përket deponisë së mbeturinave, dy viteve ne atë deponi rregullisht e kemi pastruar, ndoshta dy herë në vit e kemi pastruar, kemi pasur bashkëpunim të mirë me policinë, e cila na ka ndihmuar shumë ta realizojmë atë shumë mirë.

Dy vitet e fundit askush nuk kujdeset, por vetëm se mbeturinat hedhen edhe më shumë, ashtu që sot edhe është bërë deponi e madhe aty.

Përveç kësaj, kemi problemin e qenve endacakë, ku në orët e vona në mbrëmje njeriu nuk guxon të kalojë andejpari.

Ai në vazhdim tha se kjo ka qenë edhe më parë, por në këtë masë nuk ka qenë, pasi që ne jemi kujdesur, mirëpo tani është në numër më të madh dhe shqetësuese, si dhe kemi kërkuar disa herë nga policia të dalë dhe të intervenojë si dhe ka qenë bashkëpunimi i mirë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Ndërsa këto dy vitet e fundit nuk po di se çka po ndodh pra kjo është një problem i madh.

**Mirsada Behluli**, sa i përket mbeturinave, tha se nuk është problemi vetëm aty, por është problemi në të gjithë Kosovën, ku edhe në Prishtinë, posaçërisht në lagjet e reja, nuk është i rregulluar projekti për mbeturina.

Ja këtu e kemi edhe përfaqësuesen e Kuvendit, znj. Ema, ku këtë çështje duhet ta ngremë në nivel më të lartë që kjo vërtet të rregullohet, sepse është kryeqytet i Kosovës dhe duhet të jetë i pastër, duhet të ketë kontejnerë në çdo lagje.

**Elmira Nikçi – Rexha**, sa i përket mbeturinave, tha se kjo nuk ka të bëjë vetëm me komunitetet, por për të gjithë qytetarët që jetojnë këtu. Ajo në vazhdim tha se tani është një gjendje pak më e mirë në disa lokacione, por jo në të gjitha lokacionet. Pra një gjë e mirë është se do të vendosen kamerat nëpër qytet, ku do të bëhet identifikimi i personave që i bëjnë këto shkelje, që janë shkelje të dënueshme që nuk aplikohet ligji prej Policisë së Kosovës.

Ndërsa sa i përket deponive të mbeturinave, tha se ato janë gjithkund, jo vetëm në Bërnicë, në çdo vend që është mundësia me u zbrazur ato do të zbrazen. Është mirë që kur i sheh me i lajmëruar, policia, ekzistojnë organet e rendit.

#### Pika e katërt

##### Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale

**Mirsada Behluli** tha se në takimin e kaluar, më 30.01.2024, anëtarët e Komitetit kanë pasur një vërejtje në zvogëlimin drastik të ndihmave për familjet në gjendje të rëndë ekonomike.

Në vitin 2022, janë përkrahur 175 familje me ndihmë të njëhershme për dru zjarri për komunitetet jo shumicë.

Mirëpo ky numër në vitin 2023, është zvogëluar në 70 familje ( 20 prej tyre kanë qenë raste sociale dhe 50 prej tyre kanë qenë në gjendje të rëndë ekonomike) do të thotë 105 familje më pak janë përkrahur në krahasim me vitin 2022.

Ajo në vazhdim tha se përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë kanë shprehur pakënaqësi për qytetarët e komuniteteve të tyre që janë numër i madh me gjendje të rëndë ekonomike dhe kanë kërkesë që këtë vit të merren parasysh që ky buxhet për vitin 2025 të planifikohet sa më i madh.

**Sala Mustafa, zyrtare nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale**, lidhur me diskutimin e znj. Behluli, tha se është në njohuri dhe se përfat të keq shuma apo ndihma që është dhënë për komunitetet që përfaqësohen në Komunën e Prishtinës, është zvogëluar edhe kjo për arsyet mungesës së linjës buxhetore.

Jemi të vetëdijshëm dhe mbështetës për t'u ndihmuar komunitetet në përgjithësi, ne e dimë që edhe kjo ndihmë është e pamjaftueshme dhe jemi një zë që subvencion i dëshma të jetë akoma më e lartë se që ka qenë në vitet më parë.

Mirëpo, duhet pasur parasysh se kjo nuk varet nga një individ, por zërat janë që numri i përfituesve për ndihmë të njëherershme do të jetë më i lartë.

Ajo në vazhdim tha se të gjithë ata, thuajse 90% që kanë bërë kërkesa javën e kaluar janë përkrahur, ka pasur shumë edhe prej komuniteteve që kanë përfituar. Ne në data-bazën që e kemi nuk i identifikojmë prejardhjen, do të thotë se të gjithë janë të barabartë. Mirëpo si drejtori e dimë se mundësitet janë shumë të vogla krahasuar me nevojat jo vetëm për komunitetin, jo shumicë por për të gjithë. Mirëpo si drejtori jemi të angazhuar ta rrisim buxhetin, do ta adresoj edhe këtë kërkesën tuaj për dru zjarri që numri të jetë më i lartë edhe besoj se do të jetë një kërkesë pozitive.

Ndërsa sa i përket data-bazës sa raste sociale të komuniteteve janë, nuk e posedojmë për shkak se ne i krahasojmë të gjithë barabartë kush ka nevojë, mirëpo nëse është specifikisht e duhur kjo informatë ne do t'ua sjellim.

Për arsy se Qendra për Punë Sociale, ka personat zyrtarë që e kanë për obligim të dalin në terren dhe t'i identifikojnë dhe të dinë më saktë, ku ne përmes kësaj data-baze do të mund të sjellim numrin e saktë të secilit komunitet që është përfitues i ndihmës sociale.

**Betim Abdullahu** duke u ndërlidhur në diskutimin e znj. Mustafa, lidhur me ndihmën me dru zjarri, tha se ne si Zyrë çdo vit ju dërgojmë shkresë secilës drejtori për përkrahje për secilin projekt, realisht e marrim edhe si kërkesë të ndihmave. Ai në vazhdim tha se edhe këtë vit drejtoresha e ka shkresën për dru zjarri, edhe në shkresë është përgjigjur vetëm kryetari dhe ka kërkuar nga unë me e ditë se a po realizohen kërkesat të cilat kanë shkuar nga ana e ZKKK-s për këtë vit.

Mes tjerash ai shtroi edhe çështjen e personave të riatdhesuar, ku sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, secili person i riatdhesuar që kërkon vendstrehim në Komunën e Prishtinës, vitin e parë është një buxhet prej Ministrisë së Punëve të Brendshme, që i mbulon rastet që kanë nevojë për strehim, maksimum plus gjashtë muaj nëse ata janë të rrezikuar dhe ato plus gjashtë muaj shkojnë nëse merret raporti nga qendra, pastaj i takon nivelit komunal në tri vitet e ardhshme nëse nuk ka ndryshim në familje. Ne e kemi gjetur një gjuhë të përbashkët me MPB-në për ato familje, se shumica janë nëna vetushqyese dhe familje të cenueshme, edhe i kemi mbajtur në strehim ndoshta deri në 5-6 vjet. Edhe pse i kemi tejkaluar kompetencat tonë, këtë e kemi bërë në marrëveshje me Ministrinë e Mirëqenies Sociale.

**Sala Mustafa** sa i përket rasteve që u përmenden nga z. Abdullahu për dru zjarri, tha se zakonisht drejtoria jonë për mirëqenie sociale, në fund të vitit e bën shpërndarjen për dru zjarri. Siç thash edhe më herët, në asnjë vit nuk mund ta dimë numrin e saktë, mirëpo shpresojmë se këtë vit numri i përfituesve do të jetë më i madh. Është nga fundi i vitit që ne e planifikojmë edhe numrin e saktë në bazë të buxhetit, që realisht është i ndarë për subvencione.

Ndërsa sa i përket pagesës së qirasë, unë e përmenda se të gjithë ata persona të cilët i plotësojnë kriteret, do të përkrahen nga drejtoria e jonë për pagesën e qirasë në bazë të Rregullores së brendshme.

Sa u përket personave të riintegruar, është një obligim ligjor i komunave dhe i Qeverisë në përgjithësi, që këta persona të përkrahen deri në lirimin e tyre, që nënkupton punësimin e tyre që në vendin tonë është pak sa i vështirë tani. Kemi raste që i kemi përkrahur gjatë procesit të riintegrimit të tyre, mirëpo nëse ka pasur raste që janë dërguar vitin e kaluar, me siguri është një lloj dokumentacioni që duhet me e paraqitur para drejtorisë, siç është kontrata e noterizuar nga noteri që shumë klientë po gjejnë vështirësi në rastin e kësaj kontrate, për shkak se shumica e banesave ende nuk janë të pajisura me leje poseduese. Ku kjo paraqet problem edhe për neve si komision, sepse ne nuk guxojmë të dalim jashtë rregullores.

Kurse sa i përket aspektit ligjor, realisht aspekti ligjor është se shumë herë e implikon Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, mirëpo nuk e specifikon qartë se çfarë dokumentacioni duhet të paraqitet nga këta persona, që ne si persona përgjegjës po hasim në vështirësi për t'u ndihmuar pavarësisht vullnetit për të ju dalë në ndihmë.

**Oktay Kurtesh** shtroi pyetje lidhur me dy familjet Safqiu, të larguara nga shtëpia e cila është e pabanuar, si dhe çka është duke u bërë me jetën e asaj gruaje, pasi që nuk ka burrë, nuk ka fëmijë, asaj i ndihmojnë familjarët.

**Sala Mustafa** theksoi se sa i përket asaj gruaje, ajo për pesë vjet ka përfituar, për vitin e kaluar nuk e di, por vazhdimisht është përkrahur për pagesë të qirasë. Unë thashë edhe më herët, se ne bazohemi në Rregullore, se nëse është një person, atëherë është 100 euro në muaj, kurse 2 deri në 5 persona është 250 euro.

Ajo në vazhdim tha se e vërtetë është që pagesa prej 100 euro nuk është e mjaftueshme, mirëpo ne operojmë në bazë të Rregullores, ku për një person është 100 euro. Kjo Rregullore është në proces të ndryshimit, për shkak se jemi dëshmitarë se Pandemia ka bërë ndryshime jashtëzakonisht të mëdha në çmime, ku hyjnë edhe pagesa e qirasë. Pra duke u nisur nga ky fakt, është në proces ndryshimi edhe shuma e mbështetjes së pagesës.

**Nenad Miladinoviqi**, sa i përket Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, tha se dy gjëra me rëndësi janë për ne, ndihma e njëershme dhe ndihma përfundimtare për familjet në gjendje të rëndë ekonomike me dru zjarri. Ndërsa sa i përket ndihmës së njëershme, tha se e di si punon Drejtoria, kur janë ato në pyetje kjo rregullohet varësisht prej buxhetit të cilin e ka Drejtoria.

Mirëpo kur është në pyetje ndihma me dru zjarri përfundimtare për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, ne deri tani kemi bërë listat me familjet në gjendje të rëndë ekonomike të cilat kanë shkuar në drejtori. Për vitin e kaluar e kemi pasur numrin e kufizuar të familjeve, kinse për shkak të mungesës së mjeteve në buxhet, ku për këtë çështje ju kemi ftuar sot në takim, se a është e mundur që të parashikohet numër më i madh i familjeve të cilat do ta marrin këtë ndihmë dhe ta dimë se përfundimtare numër bëhet fjalë.

**Sala Mustafa** duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Miladinoviq, tha se kërkesat që i drejtojmë Zyrës përfundimtare për komunitete dhe kthim, varen nga buxheti. Nga muaji shtator e bëjmë edhe planifikimin e buxhetit përfundimtare, kështu që ju doni më herët, atëherë unë do ta

adresojë tek drejtoresha, që ne ta bëjmë këtë listë më herët, që të jemi më të gatshëm, kërkesa është shumë e arsyeshme, pér shkak se çdo planifikim i mëhershëm është se ju informon edhe juve, edhe neve.

Ndërsa sa i përket asaj që thoni, disa raste sociale nuk e meritojnë, e ka raste të tjera që nuk përfitojnë e që fitojnë dru zjarri, kjo punë i takon Qendrës pér Punë Sociale.

**Kimeta Shok** shtroi pyetje, duke thënë se, pasi që vitin e kaluar është zvogëluar numri, a mundemi këtë vit që të llogarisim pér 100 familje.

**Elmira Nikçi - Rexha** tha se vitin e kaluar është parë se është zvogëluar, por edhe para atij viti drejtoria nuk ka pasur buxhet pér 175 familje, ajo është bërë me vendim të kryetarit e jo me vendim të drejtorisë.

**Arianita Beqa - Raci - UNMIK**, i informoi të pranishmit se para dy ditësh ka ardhur thirrja pér projektet, pra projektet pér ndërtimin e mirëbesimit në mes të komuniteteve. Projekti financohet deri në 25 mijë dollarë.

Informatat janë në ueb-faqe të UNMIK-ut, në Facebook, Instagram dhe Twiter, nëse keni nevojë unë mundem të ju dërgoj edhe në listën e e-mailave tua dërgoj. Ata që aplikojnë le ta lexojnë mirë, sepse duhet të futen informatat e sakta edhe pér çdo vit ndërrohen format e aplikimit pasi që nuk është sikurse vitin e kaluar.

Mund të aplikojnë OJQ-të, institucionet nëse donë, drejtoritë.

**Mirsada Behluli** theksoi se vitin e kaluar, në muajin Shkurt kemi marrë një lajmërim nga Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit, kanë pasur shtatë pako pér ndihmë në buxhetin e tyre, do të thotë së pari ka qenë ndërtimi i shtëpive pér ata që kanë nevojë, ndërsa e dyta ka qenë rinvimi i shtëpisë ekzistuese.

Ajo në vazhdim tha se zonja nga komunitetit turk, e cila ka probleme, duhet t'i drejtohet MKK-së, të cilët duhet ti ndihmojnë pér rinvimin e shtëpisë, mobilimin e shtëpisë, si dhe pajisjeve elektrike.

Ajo në vazhdim tha se ka edhe ndihma të tjera, si p.sh. ndihma me para në shumë prej 5 mijë euro, kështu që do të ishte dashur t'i drejtohet MKK-së dhe ta rregullojë këtë problem. Ajo mes tjerash tha se lajmërimi publik nga MKK ende nuk a ardhur, të na njoftoj se 27 shkurti 2024, anëtarët e ZKKK-s edhe unë si kryesuese e Komitetit pér Komunitete, kemi qenë prezantë në prezantimin e strategjisë pér mbrojtje dhe promovimin e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre nga viti 2023 deri në vitin 2027.

Kjo strategji është përkrahur nga kryeministri z. Albin Kurti, na është përgjigjur edhe ministri pér Komunitete dhe Kthim, z. Nenad Rashiq, me bashkëpunëtorët e tij, edhe po dua që sa më shkurt t'ju njoftoj me strategjinë e këtij prezantimi.

Qëllimi i kësaj strategjie është, nën një, përfaqësimi i komuniteteve jo shumicë në administratën publike, që nënkupton punësimin që nga Ministria e deri tek ndërmarrjet profesionistëve nga të gjitha komunitetet jo shumicë.

Ideja tjetër e strategjisë ka qenë ideja e kthimit urban, punësimi i komuniteteve jo shumicë, të të tjerëve kryçja e tyre në arsim.

Qëllimi i tretë i MKK-së ka qenë që me këtë prezantim të formojë shtëpi të shoqërimit, vendër trajnimi, vendër mobile, së paku në shtatë regjione të Kosovës, me të rintjtë e trajnuar të cilët do të punonin në ofrimin mundësive të ndryshme në të gjitha sferat e jetës. Me përkrahjen e OSBE-së, e cila ka misionin të ndihmojë Ministrin e Komuniteteve dhe Kthimit, kur është fjala për kthimin e komuniteteve, stabilizimin e tyre dhe kryqen e tyre në të gjitha sferat e jetës, duke filluar nga punësimi e të tjera, si kishte mundur të mbijetojë një familje.

#### Pika e gjashtë

#### Ndihmë për subvencionim përmes Komunës së Prishtinës, biznes privat dhe donacion nga të huajt (OJQ)

**Klaudia Mula** u shpreh se informatat që ne i kemi dhenë të kuptojmë se Drejtoria e Kulturës jap subvencion për manifestimet dhe aktivitetet e ndryshme kulturore. Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se kemi bashkëpunim me organizatën IOM, e cila përkrah komunitetet, sidomos ato që janë kthyer. Tash për tash, nuk ka ndonjë thirrje, jemi takuar muajin e kaluar me përfaqësuesit e IOM-it, por ende nuk ka thirrje për projekte për komunitete.

**Mirsada Behluli** shtroi pyetje se kush i ndan pakot higjienike dhe ato ushqimore.

**Klaudia Mula** tha se ato nuk janë projekte subvencionuese, ato janë projekte që me kontratë trivjeçare, që i kanë kaluar procedurat e tenderimit, pra i kemi edhe një vit në dispozicion për t'i implementuar ato projekte.

Ajo në vazhdim tha se dy herë në vit jeni të njoftuar me buletinin, të cilin po na e dërgon Zyra për çështje të komuniteteve pranë Zyrës së kryeministrit, janë ndihma në fusha të ndryshme, siç është arsimi, punësimi, nuk e di se sa po mundeni me i lexuar ato dhe me i ndihmuar komunitetit tuaj.

**Nenad Miladinoviqi** tha se do të ishte mirë që të gjitha komunitetet të kenë informata më shumë kur është fjala për ndihma, qoftë nga IOM-i.

Thënë realisht, tek ne komuniteti serb, në të shumtën e rasteve ato ndihma i marrin njerëzit e njëjtë.

#### Pika e shtatë

#### Raporti i ZKKK-së për muajin janar 2024.

**Betim Abdullahu** theksoi se pasi që jemi shkurt me kohën si dhe shumicën e çështjeve i diskutuam më herët, tjetër nuk ka që kishte me pasur ndonjë risi në procedura dhe punën tonë.

Njëzëri u miratua Raporti i ZKKK-së për muajin janar 2024.

**Mirsada Behluli** tha se pasi që jemi tek Zyra, a kishit mundur të na sqaroni pak procedurën lidhur me festimin e festave kombëtare, se kujt duhet t'i drejtohem i për projekt apo kërkesë ZKKK-së, ndonjë drejtorie apo kryetarit direkt.

**Betim Abdullahu** lidhur me pyetjen e shtruar nga znj. Behluli, tha se ne si Zyrë e kemi secilën datë të festave për secilin komunitet, edhe ne ju kemi drejtuar Drejtorisë së Kulturës, pasi që ajo edhe i subvencionon OJQ-të që merren me programe kulturoro - artistike, por edhe festave zyrtare që janë.

Ne iu kemi drejtuar edhe Drejtorisë së Kulturës, por edhe Zyrës së kryetarit të Komunës së Prishtinës.

**Mirsada Behluli** tha se Drejtoria e Kulturës në muajin mars do ndajë subvencione, e tash a do të presim ne derisa t'i publikojnë ato subvencione e pastaj të aplikojmë.

**Klaudia Mula** u shpreh se tash unë nuk e di se kush kur e kanë, p.sh. komuniteti boshnjak e ka më 23 shtator, mundesh tash me aplikuar e me implementuar në shtator. Kur të hapet thirrja, ju mundeni me aplikuar për mbështetje.

**Pika e tetë**

**Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre.**

**Mirsada Behluli** pyeti se a ka dikush të thotë diçka rreth kësaj pike.

**Oktay Kurtesh** paraqiti shqetësimin lidhur me kafshimin e një gruaje nga qentë endacakë në rr. "Bajram Kelmendi".

Procesmbajtësja  
Lendita Spahija

Kryesuesja e Komitetit  
Dr. Mirsada Behluli

